

V E N D I M
Nr.425, datë 26.6.2003

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.116, DATË 18.3.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR REZERVËN E SIGURISË SË NAFTËS, GAZIT DHE
NËNPRODUKTEVE TË TYRË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.116, datë 18.3.1999 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 1 bëhen shtesat si më poshtë vijnë:

a) Në kategorinë II, pas fjalëve “Benzinë automjetesh” shtohen “Benzinë mjetesh të fluturimit ajror”.

b) Në kategorinë III, pas fjalëve “Gazoil (Diezel)” shtohen “Lëndë djegëse për mjetet e fluturimit ajror, reaktivë (Kerozene)”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 3.1 me këtë përmbajtje:

“3.1. Depozitat ku ruhet rezerva e sigurisë do të vlerësohen si magazina doganore, pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në Kodin Doganor dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij, sipas vlerësimit të autoritetit doganor.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano